



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

Zyra e Kryetarit të Komunës

/Kancelarija presednika opstine/mayor's office

Zyra për Informim/ Information Office/ Kancelarija za Informisanje



Nr. i Protokollit:02/781

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor në konsultimin publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029, mbajtur më 18.06.2026 (e enjte) në ora 15:00, në sallën e Kuvendit

(Me partitë politike, anëtarët e Kuvendit, Kryesuesin e Kuvendit, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe qytetarë)

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Rrahman Jakupi; Nënkryetari i Komunës Adnan Ademi; Drejtori për buxhet dhe Financa Besnik Ahmeti; Asambleistët e Kuvendit dhe qytetarët.

Rendi i ditës:

Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029

Rrahman Jakupi: Përshëndetje për të gjithë që jeni prezent sot, qytetarët e Komunës së Shtimes, në veçanti banorët e fshatit Reçak. Ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen në këtë dëgjim publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029.

Me neve sot janë prezent Nënkryetari Komunës, Drejtori i Financave dhe Zyra e Informimit. Qëllimi i këtij takimi është t'i dëgjojmë propozimet, kërkesat, prioritetet në mënyrë që ato të merren parasysh në planifikimin buxhetor të komunës së Shtimes për vitin 2027.

Sipas Draftit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, buxheti i përgjithshëm 2027 parashihet të jetë rreth 11.900.000, ndërsa informacioni sipas këtij dokumenti po ashtu që në të ardhmen do të jetë me vlerë prej 12.500.000 dhe 13.200.000 për vitin 2029.

Pjesa më e madhe e këtij buxheti shkon për pagat e punëtorëve në arsim, shëndetësi, administratë, shërbime publike dhe për investime kapitale. Shumica prej jush e dini se për vitin 2027 janë planifikuar 2.250.000 euro për investime kapitale, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Pra, mbi bazën e këtij

dokumenti, janë paraparë projekte të ndryshme që do të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik, zhvillimin e bujqësisë, arsimit, kulturës rinisë dhe sportit, dhe në rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Mirëpo, ju që jeni prezent e dini se ne nuk jemi këtu vetëm për t'i prezantuar shifrat që i përmenda më lart. Qëllimi i këtij takimi është të dëgjojmë zërin tuaj, zërin e qytetarëve dhe të marrim parasysh kërkesat, sygjerimet dhe nevojat tuaja për planifikimin dhe investimet e ardhshme,

Çdo propozim, kushdo që dëshiron të diskutojë, ju lutem ta thoni emrin paraprakisht, për arsye se do të mbahet procesverbali dhe do të mbahen shënime për propozimet që mund t'i kenë. Të gjitha këto do të shqyrtohen. Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe për kohën që keni gjetur për të diskutur në këtë dëgjim publik. Tani, kush dëshiron, mund ta marrë fjalën për kërkesa dhe propozime, ndërsa në fund do të mundohemi tju përgjigjemi të gjitha kërkesave që i keni paraqitur.

Demokrat Mujota: Përshendetje Kryesues, nënkryetar, përshendetje për ju asambleistë, në veçanti banorë të fshatit Reçak dhe të gjithë ju që jeni prezent. Kisha dashur që, në përgjithësi, për sektorin e bujqësisë të jap një propozim për të ofruar një lloj subvencioni për litër qumështi për qumështarët e Komunës së Stimes, ku prej 47 cent sa ka qenë për litër, qumështi aktualisht shitet me 27 cent për litër në vendim qeveritar, që të paktën me bë 10cent për litër, që të mundësojmë që ato ferma, ata prodhues të qumështit mos t'i mbyllin fermat e tyre, kur dihet që komunat e tjera e kanë të rregulluar këtë çështje, edhe ne nëse kemi mundësi me e fut në qarkore buxhetore. Kjo ishte sa i përket sferës së bujqësisë. Ndërsa nëse i referohemi fshatit Mollopolc, për 2 ura që janë në Mollopolc, njëra veç është e shkatërruar, ajo që shkon te lagjja Salihaj te shtëpia e policit Sadat Salihaj, aty rruga shumë e keqe, rivitalizimi i rrugës Islam Neziraj, rivitalizimi i pjesës së kanalizimit që është prej lagjes Sopaj deri te lagjja Salihaj te ura e madhe pasi që kanalizimi është bërë shumë keq në vitin 2018-2019, është i bllokuar, është kanalizimi i vdekur, të bëhet një muri mbrojtës te lumi. Me interes të veçantë është edhe hapja apo rregullimi i rruges, që ne si fshat kemi mendu me vendos emrin e Haxhi Behxhet Sopaj, ku prej lagjes Sopaj kalon mbi varrezat e fshatit shkon kah kulla dhe del te rruga e Rashices që i themi ne, sepse ne kohen e luftës është njohur si rruga e UÇK- së, përfshihet edhe rruga tjetër që i lidh te rruga me kalldërm që shkon për Jezerc, ku është përmendorja e një djali të ri që ka humbur jetën në mal Leotrim Neziraj, me e bë këtë lidhje nga lagjja Sadikaj te rruga e Rashicës që i themi ne në Mollopolc, këto i kemi për Mollopolc, por domosdoshmëria e punës është të paktën këtë vit ose vitin tjetër 2027 me u fut sheshi Skender Salihaj, i kemi kërkuar vazhdimisht por nuk është bërë, pas krijimit të zonës operative të Nerodimes është dëshmorë i parë në komunën e Shtimes Skender Salihaj, është çështje emocionale për fshatin Mollopolc me u rregullu të paktën ky shesh sa më parë që është e mundur, faleminderit shumë.

Bajram Hajrizi: Faleminderit Kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor, kolegë asambleistë, qytetarë të Shtimes, në veçanti bashkëvendas të mi të Reçakut. Po ia nisi prej fshatit Reçak, për problemet që i kemi vazhdimisht, probleme ka shumë, duke nisur nga infrastruktura, rruga Ahmet Kaçiku që lidhet me rrugën Tahir Sinani, që duhet të rregullohet, pastaj është edhe rruga 15 Janari që lidhet me rrugën deri te lagjja Beqaj, pastaj rruga Ahmet Kaçiku është e domosdoshme, ndërtimi i një ure pasi që ajo urë nuk i plotëson për momentin kushtet, të shikohet dhe të vendoset një ndërtim i një ure të re pikërisht afër rrugës Pavarësia. Është edhe një nevojë intervenimi në renovimin e tërësishëm të shkollës në Reçak pasi që nuk i plotëson kushtet, është dëmtimi i dyerve, dritareve, pllakave sidomos në kohen e dimrit është problem

mbajta e mësimit, është kërkesë edhe për rregullimin e ujësjellësit, që ka nevojë domosdoshmërisht të intervenohet nëse nuk na ndihmon ujësjellsi kishte me qenë mirë me gjetë donatorë për këtë zgjidhje, pasi që burimi kryesor është Vrella e fshatit Reçak, pastaj rruga Dëshmorët e Reçakut ka problem me kanalizim, dëmtimi i infrastrukturës është intervenim i domosdoshëm për shkak që fëmijët kalojnë asaj rruge deri te shkolla, edhe çështja që na shqetëson më së shumti është në kuadër të shërbimeve publike, pra mirëmbajtja e Kompleksit Memorial, faleminderit.

Avni Muharremi: Përshendetje për të gjithë, jam nga fshati Zborc, kam një kërkesë për vendosjen e shkronjave të UÇK-së te vendi ku ka rënë dëshmori i parë, hero i Ruzhdi Salii.

Xhyldane Ramadani: Përshendetje, jam nga Godanci i Epërm, kërkesa ime është për asfaltimin e rrugës Nuhi Ramadani, kërkesa tjetër është edhe trotuari në rrugën kryesore, dhe ndriçimi te rruga Dëshmorët e Godancit, rregullimi i vendparkimit te varrezat.

Nexhmedin Sylja: Përshendetje, jam nga fshati Reçak, kam vetëm një kërkesë për Kompleksin Memorial që është premtuar, kur do të fillojë puna te Kompleksi Memorial në Reçak, a ka diçka konkrete.

Haqif Arifi: Përshendetje Kryesues, asambleistë dhe qytetarë, veçanarisht nga Fshati Reçak, kërkesat në emër të qytetarëve janë të vazhdohet me punët që kan mbetur pa u kry, specifikisht asfaltimi, aty ku kanë mbetur disa segmente apo rrugë pa u shtruar, zgjerimi i rrugës kryesore Besim Sopa që lidhet me rrugën Fehmi Agani në drejtim të fshatit, të asfaltohet segmenti te familja Njazi Ahmeti, asfaltimi i rrugës te familja e Fatmir Rexhepi në lagjen Ulpiana te Rasim Sylja disa segmente, të bëhet ekspertizë e kanalizimit, instalimi i ndriçimit dhe rregullimi i trotuareve, kanal kullues te familja Ilazi. Ndërsa për në Shtime kërkoj asfaltimin e rrugës që te shpie te qendra Shpresa.

Shefshet Krasniqi: Përshendetje kryesues, nënkryetar, drejtor, qytetarë të Shtimes. Për në Dugë kërkoj rregullimin e rrjetit energjetik, largimi i deponive të mbeturinave, rojtar pylli për Dugë dhe Karaqicë, kërkoj më shumë që të bëni kujdes më të veçantë sepse mali po dëmtohet çdo ditë e më shumë. Në Carralevë, kam një kërkesë te lagjja Jetullahu te varrezat qe lidhet me rrugën kryesore është shumë e ngushtë dhe kan kërku zgjerimin e rrugës, ndriçimi nuk funksionon mirë, asfaltimi i rrugëve që kanë filluar vetëm me zhavor.

Besnik Seferi: Përshendetje kryesues, përshendetje për të gjithë pjesmarrësit në këtë dëgjim publik, në lagjen e Pajtimit është çështja e kanalizimit që përfshihen disa familje, familja Jakupi, Bytyqi edhe disa familje.

Avdullah Musliu: Faleminderit që na dhatë mundësinë për t'i paraqitur kërkesat tona. Në Reçak kemi një problem, sepse kompleksi është pa mirëmbajtje. Deri tani, mirëmbajtjen e kemi bërë vullnetarisht me banorët. Vitin e kaluar e kam drejtuar një projekt që bën fjalë për një pjesë të betonit te lapidari i Ahmet Kaçikut. Kërkoj që në vitin 2027 të betonohet edhe një pjesë tjetër.

Fatlinda Rrafshi: Përshendetje për të gjithë, në veçanti banorë të Reçakut, Kërkesat janë për Lagjen e Pajtimit: ndërtimi i rrethit. Gjithashtu, te Lagjja Ohri ka nevojë për kanalizim, ndërsa në rrugën "Dëshmorët e Reçakut" duhet të bëhet një ndërhyrje në kanalizim. Po ashtu, edhe te Lagjja Muhadini duhet të rregullohet ndriçimi, sepse ka mbetur në gjysmë. Faleminderit.

Atdhe Isufi: Faleminderit, Kryesues. Përshendetje për të gjithë. Po flas për kërkesat e fshatit Vojnovc. Fshatit i nevojitet një parking te varrezat e fshatit, ndërtimi i dy urave. Te parqet e

fëmijëve duhet të vendoset sinjalizim, pasi janë shumë afër rrugës kryesore. Në rrugën "Qazim Beqa" mungojnë kanalizimi, ndriçimi dhe asfaltimi. Ndërsa në rrugën "Bashkim Emini" kërkohet ndërtimi i trotuarit dhe riasfaltimi, pasi rruga është prerë gjatë punimeve. Heqja e deponisë pas varrezave është kërkesë e banorëve. Po ashtu, kërkohet largimi i saj dhe instalimi i kamerave. Kamera duhet të vendosen edhe te Kulla e Lirisë.

Në rrugën "Fejzullahu", disa rrugica kanë ndriçim, ndërsa rruga kryesore e fshatit Vojnovc është pa ndriçim. Faleminderit.

Albana Hoxha: Përshëndetje, kryesues. Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm, në veçanti banorët e fshatit Reçak. Kërkesa ka të bëjë me shkollat, në këtë rast me paralelen në Davidoc, e cila ka mungesë të shumë kushteve në shkollë. Mbi të gjitha, në këtë shkollë mungon fusha sportive.

Kam gjithashtu kërkesa nga vende të ndryshme për fëmijët me nevoja të veçanta, për shkak të hapësirës së vogël që ka Hendikosi këtu në Shtime. Uroj që të krijohet një vend ku ata të kenë mundësi t'i dërgojnë fëmijët e tyre për aktivitetet ditore. Rrugët "Londra" dhe "Parisi" janë ende të paasfaltuara. Rruga "Imer Devetaku" vazhdon të ketë nevojë për një pengesë për ngadalësimin e veturave, ndërsa në rrugën "Anton Çeta", afër shkollës Shkolla Emin Duraku, kërkohet vendosja e pengesave për sigurinë në trafik. Faleminderit.

Demokrat Mujota: Deshta me i përmend edhe dy çështje. Njëra ka të bëjë me asfaltimin e rrugës "Emin Troshupa" në Godanc, e cila aktualisht është vetëm me zhavorr. Gjithashtu, kërkoj që të merret parasysh edhe rregullimi/asfaltimi i rrugës "Skënderbeu" në Belinc.

Fatlinda Rrafshi: Në rr. "Përparim Boshnjaku" që është një pjesë pa u rregullu, kisha kërku që sa më shpejt me u punu në atë pjesë nuk është haspirë shumë e madhe janë disa trapa (ndalesa) që kanë qenë, faleminderit.

Besnik Seferi: Kërkesa ka të bëjë me çështjen e trotuarit në rrugën "Çamëria", e cila të çon te shkolla. Ky trotuar është jetik për të gjithë banorët, e në veçanti për nxënësit. Po ashtu, një çështje tjetër lidhet me shkollën "Emin Duraku", ku duhet të gjendet një zgjidhje për ndalimin dhe qarkullimin e veturave në afërsi të shkollës. Faleminderit.

Nexhmedin Sylja: A keni qitë një kaci zall në Reçak? Ujë nuk kemi, çerdhe nuk ka, ambulantë nuk ka. Kanalet në shkollë janë të bllokuara dhe kundërmojnë erë shumë të keqe.

Bajram Hajrizi: Kam edhe një kërkesë për fshatin Petrovë, që ka të bëjë me asfaltimin e një rruge. Po ashtu, kam edhe dy kërkesa të tjera: rregullimin e asfaltit në segmentin e rrugës "12 Qershori" dhe rrugës "Përparim Boshnjaku", si dhe ndërtimin e një kanalizimi atmosferik në Davidoc.

Adnan Ademi: Faleminderit, Kryesues. Përshëndetje për të gjithë, edhe për subjektet politike, në veçanti për qytetarët që janë prezentë. Nuk dua të flas politikisht. E di që ka shumë kërkesa, jo vetëm këto, por edhe të tjera që i kemi para vetes. Sa i përket shkollës në Reçak, është e vërtetë që gjendja nuk është e mirë dhe ka nevojë për investime. Megjithatë, me buxhetin që kemi tani nuk ka mundësi të realizohet, sepse shkolla kërkon një investim prej rreth 1 milion eurosh. Sa i përket rrugës, është e vërtetë që operatori ka qenë i papërgjegjshëm. Ai është dashur ta asfaltrojë rrugën, por i ka tërhequr makineritë dhe nuk është kthyer për ta përfunduar punën.

Kjo pjesë është dashur të realizohej jashtë kontratës, për shkak të shkronjave të UÇK-së, sepse ashtu jemi dakorduar. Megjithatë, sapo të na jepet mundësia, do ta përfundojmë.

Çështja tjetër ka të bëjë me Kompleksin e Reçakut. E vërteta është se deri para dy muajsh mirëmbajtja ka qenë e rregullt, por ju e dini se kjo çështje menaxhohet përmes agjencisë dhe jo komunës. Agjencisë i ka skaduar kontrata me operatorin dhe nuk është në dorën tonë që ta zgjidhim drejtpërdrejt. Nga ana jonë, çështjen e kemi dërguar në nivelin më të lartë shtetëror, në Qeveri. Aktualisht janë duke u zhvilluar procedurat për Reçakun. Pritet të përfundojë projekti, të hapen procedurat e tenderimit dhe më pas të fillojnë punimet. Megjithatë, nuk mund të them saktësisht se kur do të nisë realizimi. Faleminderit.

Nexhmedin Sylja: A ka mundësi që të paktën të bëhet kanalizimi nga banjot e shkollës deri te rruga poshtë?

Albana Hoxha: Kërkoj asfaltimin e rrugës brenda, te shkolla "Emin Duraku", te shtëpia e përshpirtshme.

Besnik Ahmeti: Përshëndetje për të gjithë. Faleminderit, Kryesues. Projektet e reja, të cilat i ka përmbaruesi, po i sqaroj përsëri para qytetarëve. Në momentin që vjen një vendim nga Gjykata, ne nuk kemi të drejtë të nisim një projekt të ri derisa të zgjidhet ajo çështje.

Rrahman Jakupi: Faleminderit shumë të gjithëve. I vlerësoj shumë propozimet dhe idetë tuaja. Shpresoj të shihemi edhe në mbledhjet e tjera të radhës. Faleminderit.

Mbledhja përfundoi në ora:16:50



Procesmbajtëse: Vlora Hyseni



**Lista e pjesëmarrësve në konsultimin publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore
(KAB) 2027-2029.**

(Me partitë politike, anëtarët e Kuvendit, Kryesuesin e Kuvendit, Komitetin për Politikë dhe
Financa dhe qytetarë)

Shtime, 18.6.2026 (e enjte)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1.	Xhyllfidane Ramadani		
2.	Fatinda Rrafshi	Kuvendi Komunal	
3.	Egzona Selmani		
4.	Albana Poduonica	Kuvendi Komunal Shtime	
5.	Demokrat Mujeta	K.K.-SHTIME	
6.	Bajram Hajrizi	K.K.-SHTIME	
7.	Minush Brehimi		
8.	Ardalloh Musliu		
9.	Herhmatin Ilye	K.K.-SHTIME	
10.	Selatin Gjokup	K.K.-SHTIME	
11.	Elton Ayri	I. d.m.	
12.	ANDHE ISUFI	K.K.	
13.	Erza Salija	K.K.	
14.	Arni Miehenei	F. shetit	
15.	ADELINA SHABANI	K.K.	
16.	Albana Ramadani	K.K.	

17.	Tenta Jus tofa	Zyra për informim	T. Jus tofa
18.	Admirë Selmani	Zyra për informim	Admirë Selmani
19.	Albion Shebani	K. Shtime	Fotë
20.	Besnik Seferi	Këshilltar i Kuvadit	Besnik Seferi
21.	Shefket Krasniqi	Këshilltorë	Shefket Krasniqi
22.	Rahman Jakupi	Kryesori i Kuvadit	Rahman Jakupi
23.	BESNIK AHMETI	DBF	Besnik Ahmeti
24.	Vlora Jipseri	Zyra për Info.	Vlora Jipseri
25.	Adnan Ademir	Z. Ekryetarit	Adnan Ademir
26.			
27.			
28.			
29.			
30.			
31.			
32.			
33.			
34.			
35.			
36.			
37.			
38.			
39.			